



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3039/12 Prot.

Tiranë, më 14.11 2023

VENDIM

Nr. 126 dt. 14.11 2023

“PËR
RIORGANIZMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER SHKENCOR NË
“AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI”
NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT”

Mbështetur në nenin 3 pika 2, gërma b, 35, 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në Udhëzimin e MAS nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizmin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, nenit 7 pika 2 gërma 5, 20 të Statutit të UST-së, neni 7, 48, 52,53 të Rregullore së Universitetit të Sporteve të Tiranës, Vendimit të Rektoratit nr.116, datë 03.11.2023; Senati Akademik në mbledhjen e datës 14.11.2023,

V E N D O S I :

1. Të riorganizojë programin e studimit Master Shkencor në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, sa i përket përmbajtjes së këtij programi (Relacioni i Departamentit bashkëngjitur).
2. Dokumentacioni përkatës ngarkohet në platformën e-Albania për miratim të mëtejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
3. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT
DEPARTAMENTI I LËVIZJES DHE SHËNDETIT

Lënda: Relacion mbi riorganizimin e programit të Ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”

Në kuadër të përshtatjes ndaj nevoja të tregut lokal, rajonal dhe europian mbi edukimin në fushën e Aktivitetit Fizik, Shëndetit dhe aspektit social, lindi nevoja e riorganizimit të brendshëm të kurrikulës së programit të studimit në Master i Shkencave “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”. Ky riorganizim vjen edhe si nevojë për përafrimin sa më të mundshëm të kurrikulës sonë me ato rajonale, për të qënë të gatshëm në një të ardhme për mundësinë e programeve të përbashkëta të studimit, siç janë dhe direktivat nga Qeveria Shqiptare.

Siç e dimë, aktiviteti fizik është, së pari, pjesë e kurrikulës së arsimit parauniversitar në vendin tonë. Si rezultat i sensibilizimit të mediave dhe botës akademike, ka një ndërgjegjësim në rritje të të gjitha kategorive të moshave mbi aktivitetin fizik për shëndet, kohën e lirë dhe shfrytëzimin e këtyre potencialeve të jashtëzakonshme për rritjen e cilësisë së jetës dhe parandalimin e sëmundjeve. Kjo situatë e re, padyshim, ka sjellë një rritje të ndjeshme të nevojës për specialist të lartë në arsimin publik dhe privat, duke bërë që ndjekja e studimeve të larta të ciklit master shkencor, të vijë në rritje të vazhdueshme nga viti në vit.

FVFR-ja ka një trend aktual prej 15-25 studentë në vit, Master Shkencor, dhe kjo shifër ka tendencë rritjeje nga viti në vit, duke fuqizuar kërkesën për specialist të aktivitetit fizik për shëndet në ciklin e dytë të studimeve. Specialistët e lartë, të Aktivitetit fizik kanë një rol të pazëvendësueshëm në mbulimin e kërkesave të popullatës për aktivitet fizik, sport dhe shëndet në kohën e lirë e cila është një garanci e provuar shkencërisht që parandalon sëmundjet, siguron një jetë aktive të shëndetshme dhe vonon procesin e plakjes gjë e cila mundëson një popullatë të shëndetshme dhe me cilësi jete të spikatura.

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

Dr. Valbona GOLEMI